



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 373 Prot.

Durrës më, 21/5/2023

V E N D I M

Nr. 24 Datë 21/5 2023

PËR

"MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" SI DHE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL (2 VJEÇAR), NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE PROFESIONAL SI DHE NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË", PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69 pika 3, si dhe referuar shkresës Nr.676 prot., datë 20.04.2023 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës Nr.676/1 prot., datë 26.04.2023 të Fakultetit të Biznesit, shkresës Nr.676/2 prot., datë 26.04.2023 të Fakultetit të Edukimit, shkresës Nr.676/3 prot., datë 28.04.2023 të Fakultetit të studimeve Profesionale, shkresës Nr.676/4 prot., datë 28.04.2023 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, bazuar në Statutin dhe Regulloren e UAMD, lidhur me përcaktimin e kriterëve për të tre ciklet e studimit, për vitin akademik 2023 – 2024, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik ,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor si dhe në programet e studimeve me karakter profesional (2 vjeçar), në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Profesional si dhe në ciklin e tretë të studimeve, "Doktoratë", për vitin akademik 2023-2024, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët.
 - Administratori.
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanëla SOTIROFSKI